

2 Pensionet e AHV/AVS
Jo reduktimit në kurriz të grave

3 Solidariteti dalje nga kriza
Mbi 20 000 veta nënshkruajnë apelin

4 Koronavirusi dhe karantina
Pandemia dhe pushimet në vendin/et amë

Nr. 5 | shtator 2020 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Takimi i shoqatave të migrantëve kundër nismës kufizuese të SVP/UDC

Bashkë kundër nismës perfide të SVP/UDC



Ana kreative dhe artistike e takimit me përfaqësues të shoqatave të mobilizuara të migrantëve © Ibrahim Öztürk

Në lokalet e Sindikatës Unia në Bernë, të shtunën e 29 gushtit 2020 është mbajtur takimi me parullën «Solidaritet në vend të përkufizimit» që ka të bëjë me votimin kundër iniciativës kontroverze të Partisë SVP/UDC, që është e njohur edhe si «iniciativa e pezullimit të marrëveshjes për qarkullimin e lirë të personave». Në këtë takim ishin të pranishëm rreth 50 përfaqësues dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme të migrantëve në Zvicër, aktivistë të Sindikatës Unia, të sindikatave dhe partive të ndryshme progresive.

Hilmi Gashi

Fjalën përshëndetëse e mbajti kryetarja e Sindikatës Unia, Vania Allewa. Ajo mes tjerash tha, se lufta kundër kësaj iniciative është luftë për mbrojtjen e të drejtave të mërgimtarëve dhe punëtorëve. Sulmi i SVP/UDC-së është perfid, sepse pretendon se do kufizim të migracionit, në të vërtetë ka për qëllim heqjen e shumë të drejtave të migrantëve, heqjen e sistemit të suksesshëm për mbrojtjen e pagave dhe dobësimin e të drejtave të punëtorëve.

«Ne nuk duam të kthehemi në kohën kur punëtorët e huaj jetonin në baraka të ngushta, të ftohta në periferi të qyteteve. Pa të drejtë të bashkimit familjar. Ne nuk duam të kthehemi në kohërat e turpshme, ku prindërit me leje për një sezonë nuk kishin të drejtë të merrnin familjet me vete dhe nëse e bënin këtë, fëmijët detyroheshin t'i fshehin në banesa të ngushta», tha ajo dhe apelojti te të pranishmit të angazhohen në shoqatat e tyre dhe rrethin e gjerë që kjo iniciativë e rrezikshme të mos kalojë.

Zvicrën e ndërtuan migrantët

Referatin kryesor e mbajti Fabian Molina, politikan zviceran (SP/PS & Juso) dhe deputet në parlamentin zviceran. Ai përkujtoi se Zvicra e sotme është e paimagjinueshme pa migrantët.

Në kohërat si kjo, ku kemi pasiguri të madhe në tregun e punësimit, të rrezikosh prishjen e marrëdhënieve me partnerin kryesorë, është sikur t'i biesh plumb gjurit tënd.

«1.5 Milion vende të punës varen nga eksporti në vendet e BE-së, pra çdo i treti frang fitohet prej eksportit në shtetet përreth», theksoi Molina. Sipas Molina edhe zviceranët dhe zviceranët përfitojnë nga Qarkullimi i Lirë i Personave. Gati gjysmë milion zviceranë jetojnë, punojnë dhe mësojnë nëpër vendet e Evropës.

Prishja e marrëveshjes Bilaterale për Qarkullim të Lirë rrezikon edhe 6 bilateraleve 1, sepse këto marrëveshje, sipas Deputetit Molina janë të lidhura njëra me tjetrën. «Prisjet një marrëveshje, bien edhe të gjitha të tjerat», tërheq vërejtjen ai.

Në përfundim Molina kritikoi SVP-në dhe eksponentët e saj, sidomos z. Martullo Blocher, një Miliardere, e cila sipas Molinës vet ka thënë se problemi më i madh që ka ajo nuk është numri i lartë i punëtorëve migrant, por rregulloret e shumta, të cilat mbrojnë punëtorët dhe pagat nga dumpingu në paga. «Këtë mund ta shohim edhe këtu: SVP/UDC nuk donë të kufizojë numrin e punëtorëve migrantë, por do migrantët pa të drejta. Që të mund t'i paguaj edhe më pak dhe të mbush edhe më shumë xhepat e saj dhe njerëzve të saj në kurriz të punëtorëve», përmbledh Molina. Ai apelon te të gjithë, që të mos bien në grackë të SVP-së dhe të votojnë Jo kundër kësaj iniciative, e cila nuk zgjidh probleme, por shkakton edhe më shumë të tilla.

Manifesti për një Zvicër solidare pa diskriminime

Në vazhdim të diskutimit u prezantua edhe Manifesti i Shoqatave të Migracionit, ku mes tjerash thuhet. «Pa ne migrantët, Zvicra nuk do të ishte ajo që është sot nga ana ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Në vend që të njohin kontributin e të gjithëve, politikanët dhe par-

titë populiste të krahut të djathtë përpiqen të fusin përçarje kundër njëri-tjetrit.»

E para në këtë drejtim dhe më kryesorja është SVP/UDC. Me iniciativën e re të përkufizimit, ajo tani po përpqet të mohojë të drejtat themelore të migrantëve dhe në të njëjtën kohë të përkeqësojë pagat dhe të drejtat e të gjithë punëtorëve në Zvicër. Me ose pa pasaportë zvicerane, ne me vetëdije të plotë e kundërshtojmë shkatërrimin e të gjitha të drejtave tona! Le të mos lejojmë që SVP/UDC të kalojë me idetë e saj antisociale.

Më tej, të pranishmit parashtuan pyetje e propozime të ndryshme, ndërsa me një shumicë votash u miratua edhe manifesti i shoqatave të migracionit.

Ana kreative e takimit

Paralelisht me takimin, në korridor përpara sallës ku u mbajt takimi, piktorja me prejardhje nga Chile, Tamara Caracoles, bashkë me të pranishmit ka pikturuar një pikturë të njohur si «Murales», me pejzash të migracionit.

Editorial



©Arben Llapashtica

Solidaritet e jo diskriminim

Politika përçarëse e sundo e SVP/UDC-së ka sistem. Miliarderët në parti përcaktojnë drejtimin. Të tjerët i përcjellin dhe japin ndihmë mbështetëse në parlament, administratë, media. Qëllimi: të kthejnë mbrapa të arriturat sociale me shumë luftë të vështirë si mbrojtja e pagave, kontratat kolektive të punës, pensionet e AHV/AVS, etj. Edhe përmes nismave perfide, sikur është rasti me nismën e re «iniciativën kufizuese».

Miliarderëve të SVP/UDC-së ju pengon lëvizja e lirë e personave. Ajo i ka dhënë fund statusit jonjerëzor të sezonierëve. Të merren e bihen njerëzit këtu, të shfrytëzohen dhe pastaj, kur nuk nevojiten me tej, ti kthejnë prap në vendet e tyre, nuk është më thjeshtë si më parë. Edhe sindikatat e fuqishme, të cilat luftojnë për të drejtat e punëmarrësve, për ta janë therë në sy. E gjithë kjo duhet të hiqet. Dhe nisma ofron një shans për shkatërrimin e këtyre të arriturave. Përmes videove, faqeve të gazetave, reklamave të shfrytëzuara me fyerje e paragjykimë. BE-ja dhe migrantet/ët paraqiten si kërcënime. Me qëllim të krijimit të një klime të paramenduar. Thjesht ky është një sistem.

SVP/UDC me fushatën e saj të qëndrueshme ksenofobe ka shtyrë koordinatat e sistemit politik në të djathtë. Tani varet nga radhët tona, të majtët, forcat progresive që të mobilizohemi, për të ndalojmë këtë politikë përçarëse. Për të mirën e Zvicrës. Këtë ne mund ta arrijmë vetëm nëse ne e diskutojmë hapur dhe me guxim çështjen dhe kuptimin e migracionit, të prosperitetit, të solidaritetit dhe të demokracisë.

Një refuzim të qartë me Jo nismës kufizues me 27 shtator do të ishte me këtë rast një shenjë e fuqishme.

Hilmi Gashi

News

Lantal Textiles AG anulon 55 ne vend të 75 vendeve të punës

Firma e tekstilit Lantal në vend të mbylljes së planifikuar të 75 vendeve të punës ka mbyllur gjithsej 55 vende pune. Falë angazhimit të punonjësve, komisionit të personelit dhe të Unia në procedurën konsultative u arrit të shpëtohen 20 vende të punës. Për personat e prekur nga shkarkimi pala e punëmarrësve arriti të negociojë një plan social. Lintali është përgjegjës për sigurimin afatgjatë të prodhimit in Langenthal dhe Melchnau. Unia do të shoqëroi ngushtë edhe më tej të punësuarit dhe Komisionin e personelit dhe do të vëzhgoj zhvillimet e mëtejme.

Unia kërkon nga Manor-i, që të heq dorë nga shkarkimet

Unia denoncon, se grupi i Manorit ushtron presion të papranueshëm tek të punësuarit, që ata të pranojnë rritjen e kohës së punës nga 41 në 42 orë. Në të kundërtën ata kërcënohen nga shkarkimi. Manor-i duhet t'i tërheq shkarkimet dhe të zhvillojë një procedurë konsultative transparente, të respektojnë sindikatat dhe të përfundojnë presionin e padinjitetshëm mbi personelin.

Të punësuarit e Orsay kërkojnë kompensim

10 nga 11 shitoret e Orsay në Zvicër do të mbyllen. 55 persona mbesin pa punë. Pas një procedure konsultative, e cila ishte përcjellë nga parregullsitë, fshiu kontributet e ndërmarrjes nga tavolina e propozimeve, të cilat i kishte bërë personeli për të mënjeluar shkarkimet. Ndërmarrja refuzoi edhe planin social. Kjo, edhe përkundër faktit se pas firmës Orsay qëndron një familje tejet e pasur. Përmes intervenimit të Unia megjithatë u mundësua të pengohen shkarkimet ilegale, veçanërisht ato të grave.

Përmes një aksioni të «mbylljes së dyerve» të punësuarit dhe Unia kërkuar që korporata të perceptojë përgjegjësinë sociale dhe të paguajë pagat në mënyrë retroaktive, të cilat i kishin të punësuarit gjatë punës me shkurtime.

Pensionet e shtyllës së dytë në teposhtë të mëtejme

Komisioni i Sigurimit Profesional Pensional (BVG/LPP) sugjeron një ulje të normës së interesit në nivelin më të ulët historik prej 0.75%. Kështu pensionet e shtyllës së dytë të sigurisë shoqërore pëson thyerje të mëtejme.

**Tolerancë zero për ngacmimin seksual: si në punë, ashtu edhe gjatë arsimimit****Duhet një ndryshim i kulturës**

Anita Frommenwiler

Rinia e Unia përmes një ankete me 800 ndjekës/e të zanateve u tmerrua nga rezultati, që 80 e grave të anketuara dhe 48% e burrave të anketuar së paku njëherë ishin ngacmuar seksualisht. Ngacmimi seksual dhe kalimi i kufirit mund të ndodhin në shumë lëmi jetësore. Ato shpërfaqin ankesa të thella sociale në lidhje me çekuilibrin e pushtetit në moshë, gjini, etni dhe në kategoritë tjera ndërlidhëse. Këto raporte ruhen në mungesë të sanksioneve dhe injorancës shoqërore. Një e prekur raporton tek Unia: «Fillimisht nuk kam pasur guximin, që të them diç. Kur e informova një arsimtar mbi këtë, ngacmuesi mohoi gjithçka dhe nuk ndodhi asgjë».

Jo vetëm vet kalimi i kufirit, por edhe pafuqia vepruese vijuese përmes injorancës bënë të qartë, se ne jemi ende shumë larg nga barazia. Vetëdija për kufirin e kaluar dhe pozicioni për të prekurit duhet të fuqizohet edhe më tej. Punëdhënësit, shkollat profesionale dhe institucionet e arsimimit profesional janë

të obliguara që të intervenojnë! Ngacmimi seksual nuk guxon të tabuizohet edhe më tej. Pasi përjetimet e tilla janë realitet jetësor i njerëzve të rinj. Është me rëndësi për tu treguar, që këta persona të rinj nuk janë të vetmuar dhe se me ndihmën e sindikatës së tyre dhe qendrave tjera kontaktuese mund të mbrohen.

Portali i ri online dhe masat konkrete

Unia për këtë ka krijuar një ueb portal të ri www.belaestigung-in-der-lehre.ch. Ajo ofron qasje konkrete, që këto në botën e punës dhe në mënyrë specifike në botën jetësore të njerëzve të rinj të promovohen dhe integrohen. Në këtë mënyrë njerëzit e rinj do të pajisen me instrumente aftësuese. Punëdhënësit dhe shkollat profesionale përmes pajises me rregullore mostra dhe parime udhëzuese mund ta komunikojnë dhe zbatojnë aktivisht tolerancën zero karshi ngacmimit seksual.

Pensionet e AHV/AVS**Jo reduktimit në kurriz të grave**

Marek Wieruszewski

ri vite pas dështimit të propozimit për reformën e pensioneve në votimin popullor të 2017, qeveria përmes «AHV/AVS 21» paraqiti një version të ri. Edhe partitë borgjeze planifikojnë një reformë, e cila duhet të financohet në kurriz të grave. Sindikatat e bashkuara të Zvicrës (SGB/USS) dhe Partia Socialdemokrate (SP/PS) kanë paralajmërua kundërshtim karshi rritjes së moshës së pensionit për gratë.

Të dy propozimet bazohen në idenë, që financimi i pensioneve të AHV/AVS të bëhet përmes reduktimeve të përfitimeve në pensione. Edhe më keq, kjo duhet të ndodhë në kurriz të grave. Një vit pas grevës së grave, një ndër mobilizimet më të mëdha në historinë e Zvicrës, një ide e tillë tingëllon si shumë cinike.

Gratë edhe aktualisht shumë të disfavorizuara

Pikërisht tek pensionet diskriminimi në paga i grave është i qartë dukshëm. Një e treta e grave ende nuk marrin një pension

nga shtylla e dytë e sigurimit profesional pensional – pasi që fitojnë më pak se 25000 franga në vit. «Edhe më me rëndësi janë pensionet e shtyllës së parë AHV/AVS, pikërisht për gratë» thotë deputetja e PS/SP Yvonne Feri. «Andaj ne duhet të angazhohemi për financimin e qëndrueshëm të AHV/AVS, në vend se të shkurtojmë përfitimet në pension për popullatën».

Pensionimi në moshë të rregullt aktualisht është 64 vjet për gratë dhe 65 për burrat. Çka është e vërteta, qysh sot vetëm 30% e grave punojnë me orar të plotë të punës në 10 vitet e fundit para arritjes së moshës së pensionimit. Dhe kjo, edhe pse ato me dëshirë do të punonin më shumë. Sipas të dhënave të Entit Federal të Statistikave gratë në krahasim me burrat vuajnë tri herë më shumë se sa burrat nga nënpunësimi. Mbi 40% e grave të nënpunësuaras duan më me dëshirë të punojnë në orar të plotë pune, për të rritur pjesën e punës së tyre të pjesshme edhe për 60%. Kjo rrethanë ka të bëjë me vështirësinë e harmonizimit të jetës familjare me atë

profesionale. Gratë reduktojnë kohën e tyre të punës, për tu kujdesur për fëmijët. Gratë e shtyra në moshë, reduktojnë ose e ndërpresin punën për tu kujdesur për familjarët nevojtarë pleq e të sëmurë, apo për tu kujdesur nipër e mbesa. Kjo qon detyrimisht tek pensionet më të ulëta. Rritja e moshës së pensionimit për gratë pa një kundërshtim për përmirësimin e barazisë në tregun e punës dhe ndarjen e detyrave në punët shtëpiake nuk është e pranueshme.

Nisma për pensionin e 13-të të AHV/AVS

Pasi që shumë gra marrin vetëm pensionin e ASHV/AVS, është me rëndësi që y pension të fuqizohet. Andaj Unia ka nisur një iniciativë, e cila duhet të garantojë pensionin e 13-të. Një pensioni AHV/AVS është mes 1185 dhe 2370 frangave në muaj. Njerëzit e shtyrë në moshë jetojnë në varfëri në një vend të pasur. Një gjendje e turpshme, të cilën ne duhet ta luftojmë bashkërisht. Kjo iniciativë paraqet hapin e parë drejtë pensioneve që sigurojnë ekzistencën.



Dita e aksionit në sektorët themelorë, 31 tetor 2020

JO rrogave nën 4000 Franga

Muajt e fundit kanë treguar: Të punësuarit se sektorët esencjal të shtijës kujdesit (afatgjatë), logjistikës/transportit garantojnë kujdesin dhe sigurimin parësor në Zvicër. Nën kushte të këqija e të pasigurta pune. Kjo duhet të ndryshojë.

Yolande Peisl-Gaillet, përgjegjëse e sektorit terciar

Pa angazhimin e mijëra grave dhe burrave nuk do të mund të mbulohehin nevojat jetike të vendit dhe shoqërisë.

Gratë veçanërisht të prekura

Në sektorët themelorë punojnë shumë gra. Nga to janë shumë kolege me sfond migracioni. Ato përditë japin një kontribut elementar për stabilitetin ekonomik të Zvicrës. Kjo bie në sy veçanërisht tani, në kohë krize, se sa i rëndësishëm është angazhimi i tyre i palodhshëm.

Përkundër punës se rëndësishme të tyre, ato kanë paga të ulëta dhe kushte të këqija e të pasigurta pune. Kësaj duhet shtuar edhe diskriminimin skandaloz në paga.

JO rrogave nën 4000

Puna e shitëseve/ëve, kujdestarëve dhe punonjësve në logjistikë/transport ka një çmim – ata/o meritojnë më shumë!

Unia kërkon një rritje pagash në së paku 4000.– franga x 13 muaj tek një javë pune 42 orësh. Parregullsitë dhe kushtet e këqija e të pasigurta duhet të ndërpriten. Tani më nevojitet më shumë personel, më shumë kohë për të punësuarit.

KKP me vlefshmëri të përgjithshme dhe masat shoqëruese për kujdesin, shitjen (Food-sektorin, përfshi tregtinë online) logjistikën/transportin, të cilat rregullojnë veçanërisht pagat minimale dhe kohën e punës.

Pasi aktualisht si edhe në të ardhmen nevojitet siguri, respekt dhe solidaritet, për të dalur nga kriza!

Dita e aksionit më 31 tetor 2020

Me 31 tetor në të gjithë Zvicrën zhvillohen aksione të decentralizuara, për të shprehur këto kërkesa. A do të bashkëngjitet edhe Ti, apo donë të dish më shumë rreth ditës së aksionit, atëherë informohu tek Unia e regjionit Tuaj, ose në internet tek: www.solidaritaet.unia.ch

Solidariteti është dalje nga kriza

20 000 nënshkruajnë apelin

Mbi 20000 punëmarrës kanë nënshkruar apelin për zëvendësim të 100% të pagave dhe heqje dorë nga shkarkimi. Një rrugë solidare për dalje nga kriza është e nevojshme – dhe e mundshme. Tani qeveria federale është e obliguar, të ndjekë këtë rrugë.

Ndihma shtetërore ka për qëllim ruajtjen e vendeve të punës dhe jo rritjen e dividendëve për firmat. 20% e paga të gjobitura është gjobitje financiare për punëmarrësit, të cilët edhe ashtu fitojnë pak për të jetuar.

Garanci të pagave dhe jo korona-shkarkime!

60 miliardë franga ndihmë fillestare u garanton federata firmave në krizën e koronës – dhe megjithatë numri i të papunëve rritet me masivitet. Kjo nuk bënë. Ndërmarrjet marrin mbështetje, për të ruajtur vendet e punës dhe për të paguar pagat më tej në vend se të paguajnë dividendë pronarëve të firmave.

Për pagat e ultë zëvendësim të 100% të pagave

Gati se një milion njerëz janë dukje punuar me shkurtime dhe marrin vetëm 80% të pagës të zakonshme të tyre. Shumë punëmarrës e kanë të vështirë për të kryer detyrimet për familjet e tyre.

Andaj ne kërkojmë:

- 100% zëvendësim page për pagat deri në 5000 franga.
- Jo korona-shkarkimeve. Firmat duhet që të garantojnë vendet e punës me milionat e federatës.

S'ka po, por...

Vepra, jo fjalë kundër racizmit!

nga Marie Saulnier Bloch

Sot për personat e zi në Zvicër është bërë e vështirë, për gjetur një banesë apo një punë, për të mos u burgosur nga policia, për tu natyralizuar dhe kështu për tu njohur si qytetar dhe për tu mos poshtëruar përmes një shprehjeje apo shakaje.

Për racistet/ët ngjyra e lëkurës është shenjë e «të huajit». Zvicranët/et e lindura, ata/o të natyralizuar në Zvicër, të arsimuar në Zvicër, duke punuar në Zvicër... pa marrë parasysh situatën, nëse ngjyra nuk është e bardhë, atëherë unë jam vetëm një qytetar i klasës së dytë. Edhe më tej shumë njerëz nuk janë të vetëdijshëm sa i rëndësishëm është racizmi dhe heshtin.

Ka më shumë se një shekull që dëgjojmë për «tey-popullimin e huaj». Shumë njerëz shprehjen «Negerkopf» («Kokë zezaku») e konsiderojnë si pjesë e trashëgimisë zvicerane. Dhe racizmi shkon edhe përtej ngjyrës së lëkurës. Nëse jeni mysliman/e,

jud/e apo romë, nëse emri juaj është nga Ballkani, Turqia, një shteti arab, apo nga ndonjë vend tjetër, mundësia është e madhe që të jeni viktimë e racizmit në rrafshin strukturor, institucional dhe individual.

Nëse ne nuk e luftojmë racizmin, ne lejojmë që ai të zgjerohet. Racizmi – sikur të gjitha llojet e diskriminimit – nuk duhet të ketë vend në marrëdhëniet e punës, të arsimimit dhe të punësimit, në tregun e banimit, tek procedurat e natyralizimit, në rrugë, në internet, në debatet politike apo në media, në procedurat mbi të huajt dhe azilin si dhe në praktikat policore. Me këtë rast nuk kemi të bëjmë me çështje private: Lufta kundër diskriminimit është një luftë për drejtësi sociale, ekonomike dhe politike!

Nismat ksenofobe si terren për racizëm

Më 27 shtator 2020 do të votojmë kundër nismës kufizuese. Ajo donë të na kthejë në epokën e «të huajve të padëshirueshëm».

Çka domethënë 20% më pak për të punësuarit në sektorin e pagave të ulëta

Gjoha në paga për 20% për shumë veta është financiarisht e papërbalueshme. Para së gjithash kur paga edhe në kohë normale është e ulët. Kush punon në gastronomi fiton mesatarisht rreth 4100 frangave në muaj (vend i plotë i punës). Kur hiqen 20%, mbetet një pagë për rreth 3500 frangave!

Rreth gjysma e punonjësve me punë të shkurtuar punojnë në sektorët me paga të ulëta. Në sektorët me pagat më të larta nuk ka pothuaj se fare shkurtime pune, kështu s'ka edhe pagë gjobuese.

Për ekonominë

Ruajtja e fuqisë blerëse, është tani me rëndësi qendrore. Për të punësuarit me paga të ulëta dhe të mesme, të cilët edhe ashtu kanë mjaft gjale për tu kujdesur për fëmijët, pasigurinë në vendin e punës dhe shëndetin e personave të afërm. Mirëpo edhe për ekonominë e Zvicrës.

Fushata e SVP/UDC shpërthen përmes stereotipat raciste. Në, që në ballë mbajmë vulën e «të huajve», me apo pa pasaportë zvicerane, duhet të qëndrojmë solidar. Ne duam kushte pune dhe jetese me dinjitet njerëzor për të gjithë, pa përjashtim! Bashkërisht ne themi «JO» pabarazisë së pandërprerë dhe politikës e fajtorëve kujdestar të SVP/UDC-së! Ne nuk guxojmë të lejojmë të na përçajmë. Përdërisa vetëm njëri/a nga ne trajtohet padrejtësisht, lufta jonë do të vazhdojë më tej. Ne gjendemi të gjithë në të njëjtën situatë!

Për këtë arsye dhe në përputhje me angazhimin së saj shumëvjeçar kundër diskriminimit, Unia publikoi në qershor një video dhe një dokument pozicionimi, në të cilin zëshëm dhe qartë kërkohen masa konkrete për të dhënë fund diskriminimit racor, për të mbështetur lëvizjen «Black Lives Matter» dhe shoqatat mbështetëse:

www.unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/rassismus.

Manifesti



Manifesti shoqatave të migrantëve mbi votimet përkitazi me nismën kufizuese të 27 shtatorit 2020

Solidaritet në vend të përjashtimit

Përdërisa virusi nuk është mundur, nevojitet koncepte mbrojtëse speciale në vendin e punës. Mbrojtja dhe e drejta e bashkëbisedimit të punëmarrësve duhet të zgjerohen.

Zvicra e sotme nuk mund të merret me mend pa migrantet/ët. Me decaie të tëra ne jemi pjesë aktive e zhvillimit ekonomik. Shoqëror dhe kulturor të vendit. Pa ne Zvicra nuk do të ishte kjo që është sot.

Mirëpo, në vend se ky kontribut të njëjët e pranohej dhe që në vend se atdheun tonë të përbashkët ta përparojmë, politikanët e djathtë populistë përpiqen ta përçajnë vendin. Ata emërtojnë veten si «ne» dhe ne si «të tjerët» – dhe gjithmonë flasin vetëm për veten e tyre. Kjo është e rrezikshme. Pasi politika, e cila bazohet në përjashtim, diskriminim dhe racizëm, nuk mund të ketë sukses. Vetëm bashkë mund të mund të ecim përpara, vetë shkohet prapa.

Por ata duan të shkojnë andej, të kthehen prapa në kohën e fuqisë së lirë dhe fleksible të punës, të ngjeshur bashkë në baraka dhe pa të drejta dhe, të ndarë nga familjet e tyre. Pasi, ky është qëllimi i vërtetë i nismës kufizuese të SVP/UDC-së: Në vend të mbrojtjes së pagave dhe të drejtave të njëjta ajo donë të kthehet prapa në statusin e pathënë të sezonierëve dhe liri veprimi për rrjepësit dhe shtypësit e pagave. Shumë punëmarrës dhe pa të drejta, që kryejnë punë të rënda e të mundimshme dhe që nuk mund të mbrohen.

Më shumë të drejta falë lirisë së lëvizjes

Liria e lëvizjes është një histori suksesi. Falë saj të gjithë – shtetasit/et e BE/EFTA sikur edhe zviceranët/et – mund të zgjedhin lireshëm, ku duan të jetojnë e të punojnë, mund të marrin familjet e tyre me veti dhe të jetojnë bashkë me to. Këto janë të drejta njerëzore, të cilat i garanton lëvizja e lirë e personave për shtetasit/et e BE-s dhe Zvicrës. Kjo i është bërë therë në sy SVP/UDC-së. Ajo donë që me nismën e saj të zhveshë nga të drejtat migrantet/ët dhe njëherazi të përkeqësoi pagat dhe të drejtat e punëmarrësve në Zvicër.

Ky imazh ksenofob shoqëror i orientuar në të kaluarën i SVP/UDC-së nuk është në përputhje me realitetin. Pasi, ne ka kohë që jemi këtu, si një pjesë e Zvicrës të shumëllojshme! Por, jo vetëm kriza aktuale ka treguar se ne sfidat mund të përballojmë mjeshtërisht bashkë. Si përfaqësues të migrantëve/ëve në Zvicër ne kundërshtojmë vendosmërisht sulmin karshi të drejtave tona të përbashkëta, pasi ne i qëndrojmë besnik parimit të barazisë për të gjithë. Nisma kufizuese na dëmton të gjithëve, pa marrë parasysh se të huaj/a apo zviceranë/e.

Përgjigja jonë karshi sulmit të SVP/UDC-së quhet solidariteti:

Në vend të ksenofobisë dhe përjashtimit, ne angazhohemi për një Zvicër të hapur, solidare dhe respekt-plotë.

Në vend të një politike kundër migrantëve/eve ne kërkojmë siguri qëndrimi, të drejtë në jetë familjare, liri lëvizjeje dhe qëndrimi të përhershëm si dhe trajtim të njëjtë për të gjithë!

Në vend se për interesa të një pakice ne luftojmë për drejtësi sociale dhe kushte të mira pune për të gjithë.

Për një Jo masive mbi nismën anuluese

Bashkërisht ne kundërshtojmë me vetëdije reduktimin e të drejtave tona! Ne nuk do të lejojmë, që të ngadhënjë SVP/UDC me politikën e saj asociale dhe raciste.

Bashkërisht ne angazhohemi qartë për një **JO mbi nismën kufizuese të SVP/UDC me 27 shtator 2020!**

Osman Osmani

Ju pyesni, Unia përgjigjet

I papunë: A duhet të kem punuar një vit në Zvicër, për të më takuar mëditja nga sigurimi i papunësisë?

Unë më parë isha duke banuar në Spanjë. Pastaj morra një ofertë pune në fushën e gastronomisë në Zvicër. Andaj e kam kaluar për të banuar në Zvicër. Mjerisht, qysh pas shtatë muajve punë, shefi im më ka shkarkuar, pasi nuk i ecte puna mirë. Kam dëgjuar, që në Zvicër ekziston e drejta për kompensim të mëditjeve në rast papunësie, kur dikush ka punua së paku gjatë 12 muajve. A qëndron kjo?

MARKUS WIDMER: Jo gjithësesi. Në kuadër të marrëveshjes bilaterale mund të llogaritni edhe kohën kur keni punuar në Spanjë. Ju lutem të merrni kontakt me autoritetet spanjolle të tregut të punës. Kërkoni vërtetimin për periudhën e juaj të siguruar kohore të punës në Spanjë. Autoritetet do t'ju lëshojnë formularin PD-U1, përmes të cilit mund të llogaritni koha e sigurimit. Nëse keni punuar më shumë se pesë muaj dy vitet e fundit në Spanjë, ju bashkë me shtatë muajt e punës në Zvicër plotësoni kushtet minimale të kontributeve të 12 muajve. Kështu ju, nëse i plotësoni edhe parakushtet tjera, do të keni të drejtë të përfitimit të kompensimit të mëditjes nga fondi i papunësisë.

(Work, 26 qershor 2020, e adaptuar)

Shitoret në pikat e karburantit: A duhet unë që në kohën time të lirë të përgatiti hapjen e shitores?

Unë punoj rregullisht gjatë ditëve të punës në një shitore në pikën e karburanteve. Shitorja gjatë javës rregullisht është e hapur nga ora 6 deri në 23. Eprori im kërkon nga unë që unë të jem në shitore në ora 5:30, për të përgatitur gjithçka për hapjen e shitores. Kjo kohë as regjistrohet e as shpërblehet, pasi kjo kohë është jashtë orarit të hapjes së shitores. Edhe kolegët e kolegët e mbyllin shitoren e kanë po të njëjtin problem. A është kjo korrekte?

IGOR ZORIC: Jo. Si kohë punë vlen e gjithë koha, në të cilën ju qëndroni në dispozicion të firmës. Në rastin tuaj kjo është qysh nga ora 5:30, pasi që ju në vendin e punës duhet të jeni në këtë kohë, për të bërë përgatitjet e nevojshme dhe për të hapur shitoren dhe filluar me punën tuaj. E njëjta vlen edhe për kolegët dhe kolegët tuaj. Vetëm kur të janë përfunduar të gjitha punët obliguese dhe kur të është mbyllur shitorja, atëherë përfundon edhe koha e punës. Nëse, pos kësaj, puna kryhet në kufirin e kohës së natës (sipas rregullit në kohën mes orës 5 dhe 6 si dhe nga ora 23 deri 24) atëherë punëdhënësi duhet që për punën e bërë natën t'ua paguajë edhe shtesën për punë natën në lartësi prej 10%.

(Work, 21 gusht 2020)

Shkurtimi i pushimeve: A lejohet shkaku i orarit të shkurtuar të punës?

Vitin e kaluar isha i sëmure mbi një muaj. Për këtë arsye firma ime mi ka shkurtuar pushimet. Shkaku i krizës së koronës ka vendosur shkurtim pune. Andaj unë kam drojën se do të shkurttoj përsëri edhe pushimet. A lejohet kjo?

MYRIAM MUFF: Jo. Parakushtet për shkurtim të pushimeve janë të rregulluara me Nenin 329 e të Drejtës obligative. Shkurtimi i punës aty nuk është paraparë si arsye për shkurtim pushimesh. Shkurtimi i pushimeve është i lejuar vetëm në rastet si në vijim: Nëse një punonjës është vet fajtor për pengimin e punës, apo nëse punonjësi shkaku i sëmundjes, aksidentit, plotësimit të detyrimeve ligjore, ushtrimin e një detyre publike apo pushimeve të të rinjve, nuk mund të punoi. Asnjëfarë shkurtimi ndodh kur pengimi i punës është më i shkurtër se një muaj për vitin shërbyes, apo nëse arsye e pengimit të pafajshëm të punës nuk është paraparë me ligj, sikur është fjala tek shkurtimi i punës.

(Work, 12 qershor 2020)

Kriza e koronës dhe karantina

Pandemia dhe procedurat pas hyrjes në Zvicër

Shqipëria deri më 20 gusht nuk gjendej në listën e vendeve me rrezik të shtuar dhe kështu deri me këtë datë për bashkëkombësit tanë dhe të tjerët ekzistonte alternativa për pushime verore. Por, kjo situatë tanimë ka ndryshuar. Kushdo që nga enjta e datës 20 gusht 2020 kthehet nga Shqipëria në Zvicër obligohet të futet në vet-karantinë.

Detyrimi për lajmërim: Detyrimi për qëndrim në karantinë vlen për të gjithë qytetarët, të cilët kanë qëndruar në vende me rrezik të shtuar. Karantina vlen edhe për fëmijët.

A keni hyrë në Zvicër dhe a keni qëndruar në një periudhë kohore të 14 ditëve të fundit në një shtet apo territor me rrezik të rritur të infektimit? Atëherë duhet të ndiqni procedurat vijuese:

- Shkoni menjëherë pas hyrjes në Zvicër në shtëpinë tuaj apo në banimin e përshtatshëm.
 - Ju duhet që pas hyrjes suaj në Zvicër për 10 ditë të qëndroni aty. Ndiqni udhëzimet mbi karantinën.
 - Lajmërohuni brenda dy ditësh (48 orësh) tek autoritetet përgjegjëse kantonale.
 - Ndiqni udhëzimet e autoriteteve.
- Dokumenti (PDF) «Udhëzimet mbi karantinën» në shumë gjuhë të migrantëve e migrantëve mund ta gjeni këtu.

Informacionet mbi karantinën

Në karantinë duhet të qëndrojnë personat, të cilët kanë pasur mundësinë të infektohen nga koronavirusi. Për të mënjeluar zgjerimin e sëmundjes, nuk duhet të keni kontakte personale me personat tjerë. Gjatë karantinës personat e prekur qëndrojnë në shtëpi apo në një bënim të përshtatshëm dhe nuk largohen nga ky vend.

Kush duhet ti përmbahet karantinës dhe sa zgjat ajo? Çka duhet pasur parasysh, nëse jeni në karantinë dhe banoni edhe me të tjerë? Këto dhe informacione tjera mund ti gjeni në dokumentin (PDF) «Udhëzimet mbi karantinën»

- Nëse shkaku i karantinës të kthyerit nuk mund të punojnë dhe nëse nuk marrin pagë nga punëdhënësi, vlen me sa vijon:
- Ekziston e drejta e përfitimit të kompensimit shkaku i koronës, nëse në karantinë ju është dashur të hyni pa fajin tuaj. Pa fajin tuaj domethënë, që destinacioni i pushimeve tuaja në kohën e udhëtimit nuk ka qenë në listën e vendeve dhe territoreve me rrezik të lartë infektimi dhe që ju në kohën e udhëtimit edhe shkaku u paralajmërimin zyrtar nuk keni mundur ta dinit, që destinacioni i pushimeve tuaja gjatë pushimeve është futur në listë.
- Nuk keni të drejtë në kompensim, nëse destinacioni i pushimeve tuaja me rastin e udhëtimit tuaj jashtë Zvicrës ka qenë në listën e shteteve apo territoreve me rrezik të lartë infektimi.

Pagesa e kompensimit në rast të humbjes të të ardhurave shkaku i krizës së koronës zhvillohet përmes fondit të kompensimit të AHV /AVS. Informacionet e mëtejme mund ti gjeni në ueb faqen e sigurimit të AHV/AVS, apo në ueb faqen e Entit federal për Sigurimet Shoqërore.


Mbikëqyrja e respektimit të karantinës

Autoritete kantonale janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të masave të karantinës dhe zhvillojnë kontrolle sporadike. Ju do të merrni të dhënat kontaktuese për personat që kanë hyrë në Zvicër. Të dhënat kontaktuese janë nga përzgjedhjet e rastësishme të fluturimeve ajrore, gjegjësisht të udhëtimeve me autobusë.

Bashkëbanorët, të cilët vet nuk udhëtojnë

A banoni bashkë me një person, i cili pas hyrjes në Zvicër duhet të futet në karantinë? Në këtë rast mënjaroni kontaktin me per-

Ndiqni më tej rregullat për higjienën dhe sjelljen. Sepse koronavirusi i ri nuk duhet të përhapet sërish më shumë.



Në rastin e simptomave të sëmundjes testohuni menjëherë dhe qëndroni në shtëpi.



Jepni gjithmonë të dhënat e kontaktit për gjurmueshmërinë kur është e mundur.



Në rastin e testit pozitiv: Izolimi. Në rastin e kontaktit me personin e testuar pozitivisht: Karantina.



Mbani distancë.



Lani duart me kujdes.



Shmangni shtrengimin e duarve.



Kollituni ose teshtini në shami ose në këndin e bërrvilit



Vetëm pas njoftimit me telefon shkoni në klinikën e mjekut ose në repartin

Fëmijët

Fëmijët, të cilët hyjnë në Zvicër pas qëndrimit në një shtet dhe territor me rrezik të rritur të infektimit duhet gjithashtu ti përmbahen karantinës për 10 ditë.

Vazhdimi i marrjes së pagës apo kompensimit?

Fillimisht duhet të shqyrtohet se a ekziston detyrim pagese ana e punëdhënësit bazuar në kontratën e punës. Vlerësimi i vazhdimit të pagës bëhet mes jush dhe punëdhënësit tuaj. Në rast kontestimi duhet të vendos gjykata.

Në dy raste sigurohet vazhdimi i marrjes së pagës:

- Nëse nga ana e punëdhënësit tuaj jeni dërguar për të punuar në një vend apo territor me rrezik të lartë infektimi dhe me rastin e kthimit në Zvicër duhet të hyni në karantinë.
- Nëse edhe përkundër karantinës duhet të punoni më tej, pra në shtëpi (Homeoffice).

sonin në karantinë bazuar në dokumentin (PDF) «Udhëzimet mbi karantinën».

Nëse këto udhëzime ndiqen nga të gjithë banorët e një ekonomie shtëpiake, atëherë do të mund të vazhdoni më tej përditshmërinë tuaj normalisht pa pasur nevojë të hyni vet në karantinë-

Rregullat e sjelljes dhe të higjienës mbeten të rëndësishme edhe në situatë të tillë.

Informacione të mëtejme

Pyetje dhe përgjigjet e shpeshta mbi këtë temë mund ti gjeni si në vijim:

Linja informative për personat, të cilët hyjnë në Zvicër: +41 58 464 44 88 (çdo ditë nga ora 6 deri 23).